

Fletë informuese 8:

HEC Vinjoll: Konflikti për përdorimin e ujit përshkallëzohet në viktima.

Përshkrimi	Më 2 gusht 2009, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Energjisë nënshkroi një kontratë koncesionare me Komp Energy shpk, për ndërtimin e hidrocentraleve Vinjoll, Hurdhas 1, Hurdhas 3 dhe Hurdhas 3. HEC-et ndodhen në Vinjoll, në zonën e Kurbin. Punimet e ndërtimit nisën në vitin 2012-të dhe banorët vendas kanë protestuar për ndërtimin e hidrocentralit në Vinjoll, për shkak të mungesës së ujit për bujqësi dhe vaditje, duke qenë se përdorej i njëjti burim uji. Protesta të shumta u organizuan në qershor të vitit 2014-të nga fshatarët duke argumentuar se devijimi i ujit ndikonte drejtpërdrejt në ekonomitë e tyre familjare të lidhura me bujqësinë. Më parë në 24 mars 2014, një shpërthim tritolli u bë në fshatin Gallat (afër Vinjollit), lidhur me një konflikt prone ndërmjet koncesionar-it të hidrocentralit dhe një banori vendas. Më 2 prill 2016, babai i pronarit të hidrocentralit, vrau një banor vendas nga Vinjollit për shkak të konfliktit të zgjatur, lidhur me pronësinë e tokës ku u ndërtua hidrocentrali. Në të vërtetë konfliktet e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Kurbin lidhur me HEC-in në fjalë kanë qenë të shumta, kur në 02.01.2015 një banor vendas, devijoi ujin nga tubacionet e hidrocentralit në kanalet vaditëse dhe u dënua për vetëgjyqësi. Kompania, shfrytëzoi burimet e Gurrës së Vinjollit dhe përmes devijimit me tuba çeliku, e dërgon ujin në godinën e hidrocentralit dhe më pas gjithë hidrocentralin njëri pas tjetrit. Banorët vendas, janë të irrituar dhe në tension konstant për shkak të ndërtimit të këtij HEC-i dhe menaxhimit të ujit.
Të dhëna kryesore	Komp Energy Shpk Kapaciteti i instaluar është 4.6 MW dhe prodhimi i parashikuar është 13.3 Gwh.
Burimi i konfliktit	Devijimi i ujit – niveli i 1-rë i konfliktit Menaxhimi i ujit - niveli i 2-të i konfliktit Të drejtat e pronës - niveli i 3-të i konfliktit
Detaje të projektit dhe aktorët	Komp Energy shpk është në pronësi të Fitim Lalës (51%) një banor vendas me banim në New York dhe 49% të aksioneve të ndara me Michal Morciniec (qytetar Zvicerian).
Zona e projektit Niveli i investimit	Projekti i Vinjollit HEC Hurdhas 1,2,3 është rreth 1.459.854 EUR. Banorët e Vinjollit.
Konflikti dhe mobilizimi	Protestë rruge, padi, vetëgjyqësi
Ndikimi i konfliktit	Dokumentuar Ndikimi mjedisor: devijimi i ujit, të drejtat e ndarjes ë ujit. Potencial Ndikimi social-ekonomik: ndikimi në bujqësi.
Rezultati i konfliktit	Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional I pa suksesshëm pasi hidrocentrali u ndërtua.
Burime dhe materiale/Referencat	<ul style="list-style-type: none"> - Ekstrakt historik nga QKR. - http://www.panorama.com.al/konflikti-per-rrugen-e-hec-it-te-vinjollit-plumba-50-vjecarit-ne-kurbinhttps://www.youtube.com/ëatch?v=oufp-1egjauhttps://www.youtube.com/ëatch?v=1ufmgzq3mxu - https://www.asp.gov.al/index.php/17-shqip/lajmet-e-fundit/8962-mbi-vrasjen-e-ndodhur-ne-kurbin.